

KËSHILLI I VEPRIMIT RINOR LOKAL

DORÇAK PËR PJESËMARRJE

UDHËZUES PËR ANËTARËT
E RINJ TË KËSHILLAVE TË
VEPRIMIT RINOR LOKAL

DHJETOR 2013

TABELA E PËRMBAJTJES




KAPITULLI 1:	KORNIZA LIGJORE DHE FUNKSIONIMI	6
KAPITULLI 2:	MARRËDHËNIET MES KVRL DHE KOMUNËS	10
KAPITULLI 3:	MARRËDHËNIET MES KVRL DHE INSTITUCIONEVE TË NIVELIT QENDROR	14
KAPITULLI 4:	PJESËMARRJA	15
KAPITULLI 5:	VULLNETARIZMI	17
KAPITULLI 6:	MEDIA DHE KOMUNIKIMI	18



SHKURTESAT

UA	Udhëzim Administrativ
OSHC	Organizatë e shoqërisë civile
KQVR	Këshilli Qendror i Veprimit Rinor
LVL	Ligji për vetëqeverisje lokale
KVRL	KËSHILLI I VEPRIMIT RINOR LOKAL
KK	Kuvend Komunal
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MAP	Ministria e Administratës Publike
OJQ	Organizatë joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KPF	Komiteti për Politikë dhe Financa



HYRJE

Cili është qëllimi i këtij doracaku?

Në disa raste, korniza ligjore mund të shkaktojë huti dhe mund të jetë e paqartë për atë se si duhet të funksionojnë organet e themeluara për pjesëmarrje, siç janë Këshillat Lokalë të Veprimit Rinor. Si rrjedhojë, Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) ka hartuar këtë doracak për t'ju ndihmuar anëtarëve të rinj të KVRL për të kuptuar rolin, funksionin dhe përgjegjësitë e këshillit në përputhje me kornizën ligjore si dhe për të ndarë praktikatat e mira të vendosura.

Si është hartuar ky doracak?

OSBE, përmes ekipeve të saj në terren në tërë Kosovën, ka punuar ngushtë me KVRL për t'ju ndihmuar ata që ta realizojnë tërësisht rolin e tyre si përfaqësues/avokues të çështjeve rinore në komunat gjegjëse. Në këtë proces janë identifikuar disa praktika të mira dhe, me qëllim të ndarjes së tyre mes KVRL-ve, OSBE organizoi disa punëtori për shkëmbimin e praktikave më të mira gjatë vitit 2011 dhe 2012. Për shkak të popullaritetit të këtyre punëtorive, OSBE vendosi që përmes këtij doracaku t'i bëjë zyrtare këto "praktika të mira". Punëtoritë u mbajtën në Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren nga muaji maj deri në muajin qershor të vitit 2013, me qëllim të nxjerrjes së praktikave më të mira që paraqiten në këtë doracak. Më pas, këto praktika janë bashkuar, pastaj janë rishikuar nga drejtuesit rajonal të projektit dhe përfundimisht janë përfshirë në kornizën ligjore dhe parimet e qeverisjes së mirë për të shërbyer si një doracak gjithëpërfshirës ('Go-To Guide') për KVRL.

Për kë është shkruar ky doracak?

Ky doracak është shkruar për anëtarët e KVRL, të moshës 15-24 vjeçe, që sipas nenit 10 të Ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë është një formacion këshillues i organizatave rinore, që veprojnë në nivelin lokal dhe përfaqësojnë interesat e organizatave rinore dhe të rinjve tek institucionet e pushtetit lokal.

Si duhet ta përdorni këtë doracak?

Rekomandimet për veprime që paraqiten në këtë doracak janë të mbështetura në Ligjin për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë (në tekstin e mëtutjeshëm "Ligji për rininë") dhe në Udhëzimin Administrativ (UA) për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave për Veprim Rinor në Kosovë që rregullon punën e KVRL-së. Gjatë tërë tekstit të doracaku, kutitë me ngjyrë të gjelbër nënvizojnë rekomandimet për veprimet që duhet të ndërmerren për promovimin e efikasitetit, efektivitetit, transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së shtuar në punën e KVRL. Këto veprime janë të bazuara në praktikatat e mira të KVRL të identifikuar nga ekipet në terren të OSBE-së në të gjithë Kosovën dhe do të ndihmojë KVRL e juaj që të jetë më e suksesshme. Sigurohuni që të shqyrtoni secilin prej këtyre rekomandimeve dhe përshtatjani ato nevojave të komunës ku ju punoni.

Përgjegjësitë e punës së Këshillit lokal të veprimit rinor bazohen në parimin e barazisë dhe të pjesëmarrjes së barabartë për të gjithë

- neni 11 i Ligjit për rininë

KORNIZA LIGJORE

Modeli i angazhimit të rinisë që përcakton bazën për themelimin e KVRL-ve është Ligji për rininë.

Pse është i rëndësishëm Ligji për rininë?

Ligji për rininë përcakton bazën ligjore për themelimin e KVRL që mundëson pjesëmarrjen e rinisë në nivelin qendror dhe atë lokal e atë përmes KQVR dhe KVRL.

Neni 7.1 i Ligjit për rininë përkufizon detyrimet e komunës për t'i dhënë mbështetje KVRL. Koncretisht, komunat duhet t'i japin KVRL-së burime financiare dhe hapësirë publike; mbështetje për edukim joformal dhe për veprimtari tjera të iniciuara nga rinia dhe zhvillim të politikave komunale për rininë në konsultim me KVRL.

Përgjegjësitë që vijnë bashkë me këto të drejta

Duke qenë se Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (në tekstin e mëtutjeshëm 'Ministria') ka njohur kapacitetin e KVRL, ajo pret nga këto rrjete të rinisë që të bëhen partnerë në formësimin e politikave që kanë të bëjnë me rininë në nivel komunal (neni 10). Prandaj, përderisa ligji krijoi një model për angazhimin e rinisë, Ministria nxori UA në vitin 2010 që u jep KVRL një rol kryesor në krijimin e një vizioni të përbashkët për rininë në secilën komunë duke hartuar një plan veprimi rinor dhe duke bashkëpunuar me organizatat e tjera rinore (Neni 10 [1] i Udhëzimit Administrativ 9/2010 për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të këshillave rinor të veprimit në Kosovë).

Çka duhet të bëni që KVRL e juaj të jetë një avokues i suksesshëm i çështjeve rinore?

Që të siguroni se KVRL-ja juaj do të pranohet si një entitet juridik, që i jep grupit tuaj të drejtat e lartcekura, ju duhet të regjistroheshi pranë Ministrisë së Administratës Publike (MAP). Kjo është për shkak se si rrjet i OSHC rinore, KVRL i nënshtrohen respektimit të procedurave të regjistrimit të përcaktuara me anë të Ligjit për Rininë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare (neni 9 i Ligjit për Rininë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare).

1. Parashtroni kërkesën për njohje në komunat tuaja gjegjëse përmes një kërkesë me shkrim. Kjo kërkesë i dorëzohet sektorit për rini në kuadër të drejtorisë për kulturë, rini dhe sport (apo drejtorisë së barasvlershme)

Në vitin 2009 Kuvendi i Kosovës, me miratimin e Ligjit për rininë, njohu aktivizmin rinor si gur themel për zhvillimin e rinisë. Ky dokument themeltar u miratua me qëllim të përmirësimit të cilësisë së jetës së të rinjve dhe statusit të tyre shoqëror dhe promovimit të pjesëmarrjes së rinisë në procesin e vendimmarrjes.

- Neni 1 i Ligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë



Respekto procedurat komunale

Anëtarët e KVRL-së që kanë respektuar procedurat komunale për komunikim me zyrtarët komunalë kanë raportuar për një proces më të rrjedhshëm të regjistrimit. Sigurohuni që ta kontaktoni zyrtarin komunal para çfarëdo kontakti me drejtorin e kulturës, rinisë dhe sportit, apo me personat në pozitë e barasvlershme kur ta parashtroni kërkesën për regjistrim.

dhe dërgojani Qendrës për Shërbimin e Qytetarëve të komunës tuaj.

2. Komuna duhet ta vërtetojë njohjen brenda 30 ditëve, nëse plotësohen të gjitha kushtet që përcaktohen me anë të nenit 13 (3) të UA.

3. Lista e hollësishme e dokumenteve të nevojshme për kërkesën tuaj për njohjen e KVRL nga ana e komunës mund të gjendet në nenin 13(4) të UA.

4. Është në përgjegjësinë tuaj që ta njoftoni komunën për çfarëdo ndryshimi për sa i përket anëtarësimit, brenda afatit prej 8 ditësh (neni 13 [6] i UA).



Çka është Qendra për Shërbimin e Qytetarëve?

Këto zyra shërbejnë si urë lidhëse mes banorit që kërkon shërbime komunale, dhe drejtorive përkatëse që gjenden në ndërtesën komunale.

Cilat rregulla dhe struktura përkufizojnë KVRL tuaj?

Çdo KVRL duhet të hartojë statutin e saj, si dokumenti qeverisës në të cilin përcaktohet struktura e brendshme dhe rregulla përkatëse. Po ashtu, duhet të përfshini përshtypimin e qëllimit të organizatës, kriteret për anëtarësim, përbërjen e anëtarëve, rregullat që qeverisin bordet e drejtorëve, etj. Në faqen e internetit, MAP ka nxjerrë udhëzimet për hartimin e statuteve për OJQ-të dhe udhëzimet për regjistrimin e OJQ-ve (vetëm në gjuhën shqipe). Secili statut duhet të jetë i veçantë dhe që i përgjigjet nevojave të KVRL-së suaj dhe veçantive të komunës suaj.

Si mund ta sigurojë KVRL buxhetin për realizimin e aktiviteteve?



Zgjatja e mandatit

Zgjatni mandatin e Kryetarit të KVRL nga një në dy vite me statut të KVRL. Kjo do t'i mundësojë kryetarit kohë të mjaftueshme që ta kuptojë plotësisht rolin dhe përgjegjësitë e tij/saj dhe si të zbatohen ato.

Nënkryetari

Emëro kandidatin e dytë me së shumti vota si nënkryetar të KVRL. Kjo shmang çfarëdo ndërprerje të punës në rast të dorëheqjes së kryetarit të KVRL. Përfshij një dispozitë në statut që i jep nënkryetarit të drejtën për të vazhduar me udhëheqjen e kryetarit në dorëheqje të KVRL deri në zgjedhjet e ardhshme, nëse ka mbetur më pak se një çerek i mandatit.

KVRL dhe shoqëria civile

Siguro përfaqësim të shoqërisë civile në KVRL për hir të transparencës më të madhe dhe pjesëmarrjes së barabartë të OSHC rinore. Përfshij një nen në statut që përcakton se çdo OSHC rinore emëron një delegat në bordin e KVRL përmes sekretarit të KVRL, në fillim të mandatit apo pas themelimit të një OSHC rinore të re në komunë.

¹ Ministry of public administration, Department of registration and liaison with NGOs, <http://map.rks-gov.net/sq/Page.aspx?id=18> (accessed 20 August 2013).

Mbani në mend se sipas kornizës ligjore, komuna duhet t'i mbulojë të gjitha shpenzimet që rezultojnë nga organizimi i Asamblesë së KVRL dhe mund t'i mbulojë edhe shpenzimet e tjera nëse ka mjete financiare në dispozicion (neni 16 i UA). Me qëllim të sigurimit të mjeteve të mjaftueshme nga komuna për zgjedhjet e KVRL, si dhe me qëllim të përkrahjes shtesë financiare për veprimtaritë e KVRL dhe zbatimit të planit të veprimit rinor, anëtarët e KVRL duhet të sigurojnë se përpjekjet e tyre të avokimit për financim të projekteve dhe të veprimtarive përputhen me procesin e planifikimit të buxhetit të komunës.



Siguro buxhetin

Bashkërendo hartimin e planit të veprimit rinor! Puno ngushtë me departamentin e rinisë për hartimin e planit të veprimit rinor trevjeçar të KVRL. Nëse mund ta mbani komunën të përfshirë në planet tuaja dhe nëse procesi i hartimit përkon me procesin e planifikimit të buxhetit, atëherë gjasat tuaja për të fituar fonde nga komuna do të jenë më të mëdha.

Rregullo financimin e KVRL përmes avokimit me kuvendin e komunës. Disa kuvende komunale kanë miratuar rregullore për procedurat e themelimit dhe funksionimit të KVRL që parashikojnë katër burime të financimit të këshillave: pagesën e anëtarësisë nga organizatat e përfaqësuara në KVRL; subvencionet nga burimet e të ardhurave vetanake komunale; subvencionet nga niveli qendror dhe organizatat ndërkombëtare dhe donacionet dhe subvencionet e tjera nga personat dhe organizatat e tjera.

Avokoni për një linjë buxhetore për rininë në kuadër të buxhetit komunal. Puno ngushtë me drejtorinë komunale për rini, kulturë dhe sport dhe me mbështetjen e MKRS për të arritur këtë hap që do t'ia lehtësonte punën komunave për të ndarë fonde në mënyrë të drejtpërdrejtë për çështjet rinore.

Mëso për procesin e buxhetit! Procesi i buxhetit komunal rregullohet me anë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Në shtator të secilit vit, komunat janë të obliguara që të miratojnë buxhetin vjetor për vitin pasues (raport i OSBE-së, 2012 Procesi i zhvillimit të buxhetit në komunat e Kosovës: vlerësim, faqe 3). Buxheti formulohet mes datës 1 prill dhe 30 qershor. Në mënyrë që buxheti t'i pasqyrojë nevojat dhe prioritetet e banorëve të komunës, komuna duhet të kërkojë kontributin e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit përmes takimeve publike. Një cikël i dytë i takimeve publike parashihet para dorëzimit të propozim-buxhetit komunal në kuvendin e komunës deri më 1 shtator, me qëllim të rishikimit dhe kuptimit të propozim-buxheteve nga drejtoritë komunale (faqe 8, po aty).

KVRL inkurajohet që të merr pjesë në mënyrë aktive në procesin e planifikimit të buxhetit duke qenë i pranishëm në takimet publike për buxhet si dhe duke mbajtur takime individuale me zyrtarët përkatës komunalë, si me zyrtarin për rini dhe drejtorin për kulturë, rini dhe sport, ose me pozitat e barasvlershme.

Kush udhëheq KVRL-të dhe si zgjidhen ata?

KVRL-ve u rekomandohet që të mbajnë zgjedhje në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në statutet e tyre, duke qenë se zgjedhjet e rregullta janë të nevojshme për të garantuar se bordi i KVRL-ve përbëhet nga anëtarë të cilët përfaqësojnë zërin e shumicës së OSHC-ve rinore aktive në komunë. KVRL-të duhet të sigurojnë funksionimin e brendshëm demokratik në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe në përputhje me lirinë themelore të asociimit në organizata joqeveritare (neni 13 i Ligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare).

Me qëllim të respektimit të parimeve të qeverisjes së mirë për transparencë dhe llogaridhënie, KVRL-ve gjithashtu u rekomandohet që ta njoftojnë zyrtarin për rini, drejtorinë komunale për kulturë, rini dhe sport dhe çfarëdo organizate tjetër relevante së paku një muaj më herët

për datën, kohën dhe vendndodhjen e zgjedhjeve për bordin e KVRL-së. KVRL-të më tej mund të ftojnë drejtorinë komunale për rini, kulturë dhe sport, apo çfarëdo komisioni tjetër konsultativ që merret me rininë, që ta mbikëqyrin procesin zgjedhor, për të shmangur çfarëdo pretendimi për parregullsi zgjedhore.

Ndonëse nuk përcaktohen me anë të kornizës ligjore, me zgjedhjen e kryetarit të tyre dhe funksionet tjera, KVRL-të kanë themeluar bordet e tyre. Këto borde mbliidhen rregullisht, diskutojnë për çështje të ndryshme dhe ndonjëherë marrin vendime me anë të votimit.

Cili është procesi i pranimit dhe dorëzimit të detyrave mes udhëheqjes në largim dhe asaj të re të KVRL-së?

Procesi i pranimit dhe dorëzimit mes kryetarëve të KVRL-së është thelbësor për ruajtjen e kujtesës institucionale dhe nivelit të funksionalitetit të këshillave.

Një procesi i duhur i pranimit dhe dorëzimit është i rekomanduar pas përfundimit të zgjedhjeve për të siguruar një kalim të lehtë të detyrës nga njëri kryetar i KVRL në tjetrin. Procesi i pranimit dhe dorëzimit duhet të përfshijë të dhëna me shkrim apo me gojë për funksionimin e rolit të kryetarit të KVRL-së, si dhe të dhëna për materialet/asetet që i takojnë KVRL-së.

Një përshkrim i hollësishtëm i procesit të pranimit dhe dorëzimit të detyrës duhet të përfshihet në statutin e KVRL-së, duke përfshirë vendndodhjen e pranimit-dorëzimit, anëtarin e KVRL-së (p.sh., sekretari/kryetari) përgjegjës për procesin, si dhe një listë të dokumenteve dhe gjësendeve që duhet të dorëzohen. Kjo listë, mes tjerash, përfshin:

- Statutin e KVRL-së;
- Planin e veprimit rinor;
- Vulën e KVRL-së;
- Certifikatën e regjistrimit të MAP-së;
- Regjistrin e inventarit;
- Marrëveshjet e mirëkuptimit;
- Listën dhe informatat e kontaktit të OJQ-ve, që janë pjesë të KVRL-së;
- Listën dhe informatat e kontaktit të vullnetarëve të KVRL-së;
- Strategjinë për rininë;
- Letrën e njohjes nga ana e komunës;
- Autorizimin për xhironlogarinë bankare dhe informatat tjera;
- Informatat e kontaktit të OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare.



Kryej pranimin dhe dorëzimin

Organizo një punëtori për pranimin dhe dorëzimin e detyrës pas zgjedhjes së bordit të ri. Në këtë punëtori, përgatit bordin e ri për natyrën e punës, çështjet dhe sfidat me të cilat ata mund të përballen gjatë mandatit të tyre. Mos harro të diskutosh çështjet teknike të punës së përditshme të KVRL, të tilla si hartimi i rendit të ditës për takime, mbajtja e takimeve, marrëdhëniet me komunën dhe përdorimi i vulës së KVRL.

Ose, mundëso një periudhë kohore gjatë së cilës bordi i ri dhe ai në largim mund të udhëheqin paralelisht. Bordi në largim mund të qëndrojë nën hijen e bordit të ri (apo anasjelltas) para se bordi i ri të merr përsipër plotësisht detyrën, me qëllim të lejimit të dhënies së këshillave dhe vazhdimësisë në udhëheqje.

MARRËDHËNIA MES KVRL-VE DHE KOMUNAVE

Ligji për rininë përkufizon marrëdhënien mes KVRL-ve dhe organeve komunale duke përcaktuar të drejtat dhe përgjegjësitë e të dyja palëve, të cilat më tutje specifikohen në UA. Kjo marrëdhënie mund të ndahet në tri pjesë: përgjegjësitë e KVRL-ve ndaj rinisë, obligimet e KVRL-ve ndaj komunave të tyre përkatëse, si dhe obligimet e komunave ndaj KVRL-ve.

Përgjegjësitë e KVRL-ve ndaj rinisë

- Përforcimi i organizatave rinore brenda komunave përkatëse, si dhe ndërtimi i një vizioni të përbashkët për rininë;
- Hartimi i një plani komunal për veprimin rinor për të përmbushur vizionin e përbashkët;
- Promovimi i vizionit dhe planit të veprimit rinor të hartuar para komunës dhe organizatave tjera që adresojnë çështjet rinore në komunë;
- Promovimi, bashkërendimi dhe këmbimi i përvojave të mira me organizatat tjera rinore;
- Bashkëpunimi me institucionet publike dhe private për çështjet që kanë të bëjnë me rininë (neni 10.1.1-10.1.5, UA).

Obligimet e KVRL-ve ndaj organeve komunale:

- Pas themelimit, KVRL-të duhet të parashtrojnë kërkesë për njohje nga komuna përkatëse;
- Përfaqësimi i organizatave rinore në komunë para autoriteteve lokale;
- Adresimi i çështjeve rinore të komunës para institucioneve komunale, si dhe organet tjera publike e personat privatë;
- Ofrimi i mendimeve dhe këshillimi i organeve dhe institucioneve komunale për veprimet e planifikuara që angazhojnë rininë në komunë;
- Paraqitja e qëndrimeve për dokumentet ligjore dhe të tjera që kanë të bëjnë me çështjet rinore në Kosovë;
- Pjesëmarrja në hartimin, zbatimin, vlerësimin dhe udhëzimin e politikave që kanë të bëjnë me çështjet rinore në komunë;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në zhvillimin e planit të veprimit rinor dhe hartimi i peticioneve dhe rezolutave për rininë;
- Organizimi i konferencës vjetore rinore, në bashkëpunim me komunën;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në hartimin e buxhetit komunal vjetor në lidhje me rininë;
- Planifikimi i aktiviteteve vullnetare rinore dhe aktiviteteve tjera për rininë (neni 10.2.1-10.2.9).

Obligimet e organeve komunale ndaj KVRL-ve:

- Nxjerrja e vendimit mbi kërkesën për njohje të KVRL-së brenda 30 ditësh nga pranimi i kërkesës me shkrim (shih nën-kapitullin 2.2);
- Mbulimi i shpenzimeve dhe kostove të krijuara për organizimin e Asamblesë së KVRL-së (neni 16.1, UA);
- Ofrimi i hapësirës adekuate publike ku rinia mund të planifikojë, menaxhojë dhe zhvillojë aktivitetet e saj në konsultim me KVRL-në (neni 7.1.2, Ligji për Rininë).

Si mund të ndikojë KVRL-ja në politikën komunale rinore?

Përveç të drejtave që përcaktohen me kornizën ligjore për pjesëmarrje rinore, KVRL-të kanë disa përgjegjësi dhe obligime ndaj rinisë dhe organeve komunale, siç është përshkruar më lart. Secili KVRL duhet të kontribuojë rregullisht në punën e komunës, duke përfaqësuar perspektivën rinore përmes takimeve me zyrtarët përkatës komunalë dhe pjesëmarrjes së rregullt në takime të ndryshme komunale. Kjo nuk kufizohet vetëm tek çështjet rinore, por i referohet edhe politikave tjera të diskutuara në komunë, por nga këndvështrimi rinor. Për shembull, si ndikon mungesa e ndriçimit publik tek rinia që ec në atë hapësirë? Ose, si ndikon tek rinia ndërtimi i mundshëm i një objekti në hapësirë publike që përdoret si fushë loje?

Cilat takime duhet t'i vijojë KVRL-ja si përfaqësues i rinisë?

Takimet publike janë mundësi për anëtarët e KVRL-së që të kenë kontakte të drejtpërdrejta me zyrtarët e lartë komunalë, si dhe paraqesin mundësi për të dhënë mendimin mbi çështjet e rinisë në komunat përkatëse. Këto takime duhen mbajtur dy herë në vit (neni 68.1, Ligji për vetëqeverisje lokale), si dhe janë të hapur për secili person apo organizatë që ka një interes në komunë.



Mundëso takime komunale

Një KVRL ka organizuar dhe lehtësuar një numër takimesh publike, pasi kryetari kishte pranuar vlerën e shtuar të KVRL-ve në rritjen e pjesëmarrjes publike në këto ngjarje. Propozo një iniciativë të ngjashme në komunën tënde, me qëllimin e rritjes së pjesëmarrjes dhe transparencës komunale.



Merr pjesë në dëgjime publike buxhetore

Merr rol aktiv në dëgjime publike buxhetore e takime publike. Paraqit fakte dhe argumente që mbështesin kërkesat tuaja, të cilat kanë qenë të suksesshme për KVRL-të tjera në sigurimin e financimit të propozimeve në lidhje me rininë, si investimi në një objekt sportiv, fushata mjedisore dhe programe rinore.

Dëgjimet publike buxhetore parashihen të organizohen për të marrë mendimet dhe kontributet e banorëve mbi atë se si duhet ndarë buxheti gjatë hartimit të buxhetit komunal vjetor (neni 61.2, Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjshmërinë). Dëgjimet publike buxhetore mund të shfrytëzohen nga KVRL-ja si pjesë e përgjegjësisë së tij për të marrë pjesë dhe për të kontribuar në hartimin e buxhetit komunal vjetor për rininë (neni 10.2.8, UA për përgjegjësitë dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillave të Veprimit Rinor në Kosovë). Më shumë informata për procesin buxhetor komunal mund të gjenden më lart tek pjesa “Si munden KVRL-të të sigurojnë buxhetin për të financuar aktivitetet?”





Përfshirja e rinisë

Harmonizo planin e veprimit rinor me aktivitetet e drejtorive komunale. Puno afërsisht me zyrtarët komunalë në zhvillimin e planit të veprimit rinor, si dhe në shqyrtim të mëtutjeshëm nga zyrtarët tjerë si zyrtari për të drejta të njeriut dhe gjini. Kërko komente nga kryetari dhe këshilltarët komunalë si rrugë për të siguruar pronësi komunale mbi dokumentin. Përfundimisht, kur i paraqitet kuvendit komunal për shqyrtim, plani i veprimit rinor nuk duhet të jetë plan i huaj, por diçka për të cilën komuna ka një interes ta miratojë.

Krijoi politika miqësore për rininë me zyrtarët komunalë. Sigurohu që të diskutohen politikat që prekin rininë me zyrtarët e rinisë, drejtorët e kulturës, rinisë dhe sporteve, si dhe drejtorët tjerë, si dhe që roli i KVRL-së në realizimin e asaj politike të jetë i qartë.

Mbjaj takime koordinuese komunale për të ruajtur kontaktet e rregullta me zyrtarët komunalë. Mbjaj këto takime koordinuese çdo muaj me zyrtarët rinorë dhe sigurohu që të diskutohen aktivitetet e ardhme si dhe ndonjë çështje tjetër relevante.

Komitetet konsultative janë mekanizma të pjesëmarrjes, të përbëra nga banorët dhe përfaqësuesit e OSHC-ve, për të mundësuar pjesëmarrjen e publikut në proceset vendimmarrëse të komunës, si dhe janë të obligueshme sipas nenit 73 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (LVL). Komitetet konsultative mund të parashtrojnë propozime, të bëjnë hulumtime dhe të ofrojnë mendime mbi iniciativat e kuvendit komunal në pajtim me statutin komunal (neni 73, LVL). Në komunat ku komitetet konsultative janë funksionale, KVRL-të inkurajohen të kërkojnë anëtarësi, si dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në komitete të cilat merren me çështjen e rinisë. Në komunat ku këto komitete nuk ekzistojnë ende, KVRL-të duhet të avokojnë me komunën për themelimin e tyre.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) është organ këshillues për çështje të sigurisë, me përfaqësim të gjerë të komuniteteve të një komune të caktuar. Qëllimi i Këshillit është të ngrejë vetëdijen mbi natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljen e dhunshme në komunitetin lokal, të identifikojë brengat lokale në lidhje me rendin dhe sigurinë publike, si dhe të rekomandojë plane veprimi për të adresuar ato brenga, përmes përpjekjeve bashkëpunuese të autoriteteve komunale, komuniteteve lokale, si dhe policisë (neni 7, Ligji për policinë). Si organ konsultativ që përfaqëson zërin dhe brengat e rinisë, KVRL-ja inkurajohet të kërkojë anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aktive në këta këshilla.



Avoko për mjedis më të sigurt

Fillo të marrësh pjesë rregullisht në KKSBB, duke paraqitur brengat e rinisë për Këshillin, si dhe duke ofruar rekomandime.

Një KVRL ka adresuar me sukses çështjen e drogave të lehta në shkollë, si dhe komuna ka reaguar duke rritur praninë e policisë, si dhe duke ndërmarrë një fushatë kundër drogave.

Një KVRL tjetër ka ngritur çështjen e mungesës së trotuareve dhe ndriçimit publik në rrugët që shfrytëzohen nga nxënësit. Zyrtarët komunalë patën reaguar duke i krijuar që të dyja!



Vëzhgo rregullisht mbledhjet e Kuvendit

Shpërndaj procesverbalet nga seancat e Kuvendit të cilat kanë rëndësi për rininë, për shkak të diskutimit të çështjeve rinore, ose çështjeve tjera që prekin rininë. Për shembull, ndërrimi i orareve të autobusëve, çështjet e sigurisë, ndërtimit, raportet për arsimin)

Vlerëso performancën e Kuvendit. Vëzhgo rregullisht Kuvendin, Përpilo raporte me gjetjet tuaja, si dhe ofro rekomandime për përmirësim, sidomos në pjesëmarrjen publike dhe përfshirje të rinisë. Publikoje raportin.

Një KVRL ka vëzhguar të gjitha seancat e kuvendit, si dhe ka regjistruar se sa herë është përmendur fjala rini. Ai ka prodhuar një raport me gjetjet e tij, si dhe e ka ndarë atë me këshilltarët komunalë dhe mediat, duke arritur kështu që çështjet rinore të diskutohen më haptas në kuvendin komunal.

Komiteti për Politika e Financa (KPF) shqyrton dokumentet e politikave, ato fiskale e financiare, si dhe harton rregullore komunale për miratim nga kuvendi komunal. Kërkesat, projektregulloret, projektvendimet dhe dokumentet strategjike shqyrtohen në KPF dhe procedohen për miratim të mëtutjeshëm në seancat e ardhme të kuvendit komunal pas votimit me shumicë nga anëtarët e KPF-së. Ai përbëhet nga kryesuesi i kuvendit komunal, si dhe një numër përfaqësues të subjekteve politike të kuvendit komunal (neni 52.2, Ligji për vetëqeverisje lokale). Takimet janë të hapura për monitorim nga publiku.

Kuvendi Komunal është organi më i lartë ligjvënës në nivel lokal dhe është i obliguar të mbajë së paku dhjetë takime në vit (neni 43, Ligji për vetëqeverisje lokale). Pjesëtarët nga publiku lejohen të ndjekin dhe të marrin pjesë në mbledhjet e kuvendit komunal, në bazë të rregullores së punës të secilës komunë (Neni 45, po aty). Anëtarët e KVRL-së inkurajohen të monitorojnë rregullisht seancat e kuvendit komunal në komunën e tyre, për të kuptuar më mirë procesin e vendim-marrjes dhe çështjet unike që komuna i trajton në një moment të caktuar. KVRL-ja mund të shfrytëzojë këtë forum për të marrë pjesë në diskutimin e pikave të rendit të ditës në lidhje me rininë, sipas rregullores së punës së komunës. Ndërkohë, monitorimi aktiv i seancave rrit dukshmërinë e KVRL-së, si dhe mundësinë për të kuptuar zhvillimet aktuale në komunë, për t'i dhënë informatat e domosdoshme për të marrë pjesë në mënyrë konstruktive në diskutime, si dhe për të propozuar tema në lidhje me rininë tek autoritetet komunale.

MARRËDHËNIA MES KVRL-VE DHE INSTITUCIONEVE TË NIVELIT QENDROR

Çfarë është KQVR-ja dhe çfarë bën ai?

Ngjashëm me marrëdhënien mes KVRL-ve dhe komunave përkatëse, Këshilli Qendror i Veprimit Rinor (KQVR) është përgjegjës për përfaqësimin e zërit të rinisë tek institucionet e nivelit qendror (kryesisht MRKS-së). Kjo përfshin, pa u kufizuar në, përfaqësimin e organizatave rinore para qeverisë, ofrimin e rekomandimeve mbi çështjet dhe legjislacionin që prek rininë, si dhe pjesëmarrjen në hartimin e Planit Kosovar të Veprimit Rinor, si dhe buxhetit vjetor për rininë në nivelin qendror (neni 3, UA).

Si duhet të bashkëpunojnë KVRL-të dhe KQVR-ja?

Bashkëpunimi dhe përfaqësimi i KVRL-ve me KQVR-në përkufizohen me UA, në të cilin KQVR-ja garanton përfaqësim të barabartë të të gjitha organizatave rinore duke aplikuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 4.1, po aty). Secili KVRL përfaqësohet në Kuvendin e Përgjithshëm të KQVR-së përmes dy përfaqësuesve.

Marrëdhënia mes dy organeve është zhvilluar në atë mënyrë që KQVR-ja koordinon takimet në nivel rajonal, për të informuar KVRL-të për aktivitetet e ardhme, por edhe për të mbledhur ide e rekomandime për punën e tij. Ndërkohë, në masa të ndryshme, anëtarët e KVRL-së kanë bërë vizita e kontribute individuale në punën e KQVR-së. Komunikimi dhe bashkëpunimi i mëtutjeshëm mes KQVR-së dhe KVRL-ve inkurajohet, derisa KVRL-të do të mund të konsideronin vendosjen e raporteve individuale me Bordin e KQVR-së, si dhe avokimin për çështje përmes përfaqësuesve të tyre rajonale.

A munden KVRL-të të bashkëpunojnë me Kuvendin e Kosovës?

Bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës është i mundur përmes mundësisë së KQVR-së, i cili ka përgjegjësinë të theksojë çështjet në lidhje me rininë në gjithë Kosovën tek institucionet e nivelit qendror. Partnerët kryesorë të KQVR-së dhe KVRL-ve në nivel qendror janë pjesëtarët e grupit të deputetëve të rinj të Kuvendit të Kosovës, si dhe ata të Komisionit të Rinisë. Grupi parlamentar i të rinjve ka organizuar disa vizita në Kuvend për anëtarët e KVRL-ve, si dhe ka mundësuar pjesëmarrjen e KVRL-ve në punën e komisioneve të Kuvendit.



KQVR-ja duhet t'i përkrahë KVRL-të në ...

- **Njohje, duke ndihmuar në përpilimin e dokumentacionit të kërkuar për njohje të KVRL-së nga komuna, si dhe duke promovuar vlerën e shtuar të KVRL-ve para komunave të cilat ngurrojnë të bëjnë njohjen.**
- **Informim, për thirrjet për propozime dhe mundësitë tjera për financim.**
- **Hartim të rregulloreve komunale, duke këmbyer rregulloret ekzistuese dhe praktikatat e mira.**
- **Marrëdhënie me zyrtarët komunalë, duke dërguar shkresa zyrtare tek departamentet e rinisë në rast se komuna nuk ka zbatuar plotësisht kornizën ligjore për funksionimin e KVRL-ve**

Çfarë mund të bëjë Institucioni i Avokatit të Popullit për KVRL-të?

Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit është të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të individëve dhe subjekteve juridike nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike (nenin 1, Ligji për Institucionin e Avokatit të Popullit). Anëtarët e KVRL-ve kanë kërkuar përkrahje nga ky institucion në disa raste, kur është pretenduar që janë shkelur të drejtat e të rinjve.



KVRL-të kanë kërkuar mendimin e Avokatit të Popullit në një rast që ka të bëjë me të drejtën e qasjes në arsim, në lidhje me vendimin e një komune për të mos lënë një vajzë të hyjë në shkollën e mesme që ajo vijonte, për aq sa ajo mbante shaminë në kokë, si dhe në një rast tjetër, një komunë tjetër që nuk i ka lejuar një grupi nxënësish nga komuna fqinje që të vijojnë mësimet në shkollën e mesme të asaj komune.

PJESËMARRJA

Si grupe me pjesëmarrje, KVRL-të duhet të jenë gjithëpërfshirëse

Parim drejtues i të gjithë KVRL-ve duhet të jetë parimi i barazisë dhe i pjesëmarrjes së barabartë për të gjithë (neni 11 i Ligjit për rininë). Përveç të qenit zë i të rinjve në komunë, roli i KVRL-ve është gjithashtu që të fuqizojnë të rinjtë duke u dhënë atyre vetëbesim dhe mundësi për të marrë pjesë në procese të vendimmarrjes. Si rezultat i pjesëmarrjes së tyre në KVRL, gratë, pjesëtarët e komuniteteve në pakicë numerike në nivel komunal, personat me aftësi të kufizuara dhe grupet tjera në pozitë të cenueshme gjithandej Kosovës po fuqizohen dhe po u jepet mundësi për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse në nivel lokal.

Si mund ta shtojnë KVRL-të larminë e rinisë?

Sigurimi i përfaqësimit sa më të gjerë të të rinjve në strukturat e KVRL, si dhe i pjesëmarrjes së kategorive të ndryshme të të rinjve në aktivitetet e organizuara nga ata, mund të përcillet me probleme të ndryshme. Herë-herë, këto pengesa mund të jenë të natyrës teknike, të tillë si mbajtja e takimeve në vende ku personat në karroca invalidësh e kanë të vështirë që të hyjnë. Herë të tjera, janë aspektet kulturore ato që luajnë rol si, për shembull, mosgatishmëria e prindërve për t'i lejuar fëmijët e tyre të mitur që të marrin pjesë në aktivitete që do të mbahen larg shtëpisë. Në shumë komuna, pengesat gjuhësore ndërmjet komuniteteve të ndryshme mund të paraqesin pengesë tjetër ndaj pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

Për t'ua bërë të mundur të rinjve me aftësi të kufizuara që t'i ndjekin ngjarjet e organizuara për të rinj dhe të marrin pjesë si anëtarë të barabartë në KVRL, organizatorët e ngjarjeve dhe mbledhjeve inkurajohen që t'i mbajnë parasysh nevojat e veçanta të personave me aftësi të kufizuara. Për shembull, vendi i ngjarjes duhet të jetë lehtësisht i arritshëm; prandaj, ndërtesat që nuk kanë pjerrina, apo me salla të takimit në kate më të larta ku nuk ka ashensor funksional, duhet të shmangen. Veç kësaj, KVRL-të do të mund të konsideronin që, për çdo takim, të emërojnë nga një anëtar që të jetë përgjegjës për t'ju ndihmuar të gjithë personave me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në takim, në varësi të nevojës.

Çfarë lloj ngjarjesh duhet të organizojë KVRL-ja për ta shtuar në përgjithësi pjesëmarrjen?

Organizimi i ngjarjeve tërheqëse mund ta rrisë dukshmërinë e KVRL-së, të rrisë anëtarësinë e vet dhe të shërbejë si mjet për t'i arritur të rinjtë në komunë, meqë është përgjegjësi e KVRL-së që të planifikojë aktivitete të shërbimit rinor vullnetar dhe aktivitete të tjera për të rinjtë (neni 10.2.9, UA).



Rritja e pjesëmarrjes së rinisë

Fshatrat/Zonat rurale

Themelo klube rinore nëpër fshatra dhe zona rurale me mbështetje të komunës. Organizoj vizita nëpër shkolla të mesme të atyre fshatrave ku anëtarët e KVRL-së kanë identifikuar të rinj aktivë që mund të ftohen për të marrë pjesë në organizimet e KVRL-së. Organizoj takime nëpër ato fshatra ku janë krijuar klubet e të rinjve dhe fto anëtarët e tyre për të marrë pjesë në takimet e KVRL-së. Komunikimin e rregullt ndërmjet KVRL-së dhe klubeve rinore mund ta bësh edhe përmes rrjeteve sociale. Gjithashtu, mbaj takimet e bordit të KVRL-së nëpër fshatra të ndryshme të komunave, në veçanti nëpër fshatra të largëta, dhe fto rininë lokale dhe udhëheqësit e tyre për të marrë pjesë në takim.

Komunitetet

Përfshij përfaqësues të komuniteteve në bordin e KVRL-së për të pasqyruar përfaqësimin e komuniteteve në komunë. Emëro një anëtar të KVRL-së si person kontakti për të mundësuar komunikimin në gjuhët e komuniteteve të tjera në komunë. Në fund, inkurajo pjesëmarrjen e komunitetit duke zhvilluar takime përafrore me ta dhe ftoj për të marrë pjesë në bordin e KVRL-së.

Gratë

Emëro anëtare femra në bordin e KVRL në rastet kur përbërja e tij dominohet kryesisht nga meshkujt. Cakto kuota gjinore për anëtarësinë në bordin e KVRL, për të siguruar praninë e femrës në pozita vendimmarrëse brenda strukturës së KVRL, në frymën e legjislacionit gjinor (30-40%). Vendos kontakt me grupin joformal të grave të komunës ose inkurajo anëtarët femra të KVRL-së që t'i bashkohen grupit joformal të grave për t'i përfaqësuar çështjet rinore brenda grupit. Këto lidhje do t'ju sjellin dobi që të dyja grupeve, në kuptimin që ato do të përfitojnë nga nismat e përbashkëta të avokimit dhe vetë anëtarët do të jenë shpesh më mirë të informuar.

KVRL-të mund të konsiderojnë organizimin e aktiviteteve të tilla si:

- Turnirë sportivë (me mundësi pjesëmarrjeje si për meshkujt ashtu edhe për femrat)
- Koncerte me të rinj
- Punëtori për zhvillim shkathtësish/edukim joformal
- Ekskursionë në natyrë, në vende kulturore e historike
- Festimi i ditëve ndërkombëtare (Dita Botërore e Rinisë, Dita e Tokës etj.)
- Aktivitete vullnetare
- ...dhe shumë e shumë të tjera!

“Vullnetarët nuk paguhen – jo pse puna e tyre është e pavlerë, por sepse është e pa çmim”

-Autor i panjohur

PUNA VULLNETARE

Pse ka rëndësi vullnetarizmi?

Vullnetarizmi është mënyrë e njerëzve për të kontribuar në të mirë të lagjes, komunitetit apo komunës së tyre. Ligji për rininë përcakton që puna vullnetare e të rinjve do të shërbejë si vlerë me interesa dhe përfitim për shoqërinë... do të krijojë perspektivë për ta duke u dhënë mundësi për të fituar përvojë praktikë dhe për të përmirësuar aftësitë profesionale (Neni 14).

KVRL-të anembanë Kosovës japin shumë shembuj të mirë të punës vullnetare, ngase pjesëmarrja në KVRL është një përvojë në vete e vullnetarizmit, ndërsa anëtarët e KVRL organizojnë dhe marrin pjesë rregullisht edhe në aktivitete të punës vullnetare. Angazhimi i KVRL-ve në organizim të aktiviteteve vullnetare përfshin detyra të ndryshme, duke nisur nga bashkërendimi i aktiviteteve njëditore deri të aktiviteteve më komplekse dhe më të strukturuar. Në vijim janë paraqitur ca praktika të mira.

Rregulloret komunale për punën vullnetare

Në gusht të vitit 2010, MKRS nxori një UA për punën vullnetare të të rinjve, me qëllim rregullimin e të drejtave, detyrimeve dhe procedurave lidhur me punën vullnetare të të rinjve (Neni 1 i UA për punën vullnetare të të rinjve). Në bazë të këtij udhëzimi, duke filluar nga tetori i vitit 2013, komunat kanë nxjerrë rregullore për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit. Kjo u arrit të bëhej me angazhimin aktiv të KVRL-ve dhe mbështetjen e organizatave ndërkombëtare.

Këto rregullore janë të ngjashme me njëra-tjetrën në formë edhe përmbajtje, meqenëse ato përcaktojnë kushtet kryesore të vullnetarizmit dhe sqarojnë mënyrën sesi komuna përfiton nga puna vullnetare dhe promovimi i saj. Rregulloret përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për rini dhe të mentorëve të vullnetarëve. Gjithashtu, ato mundësojnë dhënie të stimulimeve simbolike për vullnetarët aktivë në komunë, sikurse janë ofrimi i shërbimeve të caktuara publike pa pagesë.



Krijoni mundësi për punë vullnetare, Organizoni ngjarje që janë tërheqëse për rininë në komunën tënde.

Rekruto vullnetarë të rinj. Zgjeroni rrjetin e vullnetarëve nëpër komunë duke organizuar tryeza të rrumbullakëta për të filluar diskutimet rreth vullnetarizmit dhe organizoni trajnime për vullnetarë të mundshëm të rinj.

Mobilizoni vullnetarët. Ngjarja e vitit 2012 “Ta pastrojmë Kosovën” mblodhi më se 9,000 pjesëmarrës duke arritur të vullnetarët e mundshëm përmes mjeteve të informimit, mediave sociale dhe fjalë-pas-fjalë. Gjej donator për të siguruar një shpërblim për grupin pjesëmarrës më të mirë, në mënyrë që të ketë interesim.

Paraqitu vullnetar në komunitetin tënd. Kur komunës i mungojnë fondet, plotëso mungesën duke bërë punë vullnetare. Për shembull, kur komuna mbeti pa fonde, një KVRL filloi ta menaxhonte me sukses një qendër për informim të turistëve.


MEDIAT DHE KOMUNIKIMI

Si mund t'i përdorin KVRL-të mediat për t'i promovuar ngjarjet?

KVRL-të mund t'i përdorin mjetet e ndryshme të informimit në masë për të përcjellë informacione rreth aktiviteteve dhe përpjekjeve të tyre avokuese. Në varësi të efektit të synuar, KVRL mund të informojë një audiencë më të gjerë duke i theksuar rezultatet e mëparshme, duke dhënë lajme rreth nismave në vazhdim e sipër dhe duke promovuar aktivitetet e planifikuara në të ardhmen. Kur ndonjë aktivitet i veçantë i KVRL-së promovohet dhe mundohet të bëhet sa më i njohur nëpër media, është e dobishme të mbahet ndërmend se vëmendja e mediave do të fitohet vetëm nëse ndodhitë janë tërheqëse dhe me peshë për një numër të madh lexuesish dhe/ose shikuesish. Meqë puna me mediat kërkon përkushtim dhe profesionalizëm, një mënyrë efikase për të krijuar raporte pune me mediat do të ishte që të caktohet një zyrtar për informim i cili do t'i krijonte dhe mbante këto kontakte (Manik Begolli, Këshilltar për marrëdhënie me publikun, Deloitte Consulting, Prishtinë).

Avokimi përmes mediave për çështje që kanë të bëjnë me rininë

Janë dy lloje të raportimit nga mediat në të cilat KVRL mund të përfshihet për qëllim të punës së saj - proaktiv dhe reaktiv. Raportimi proaktiv nga mediat i paraprin një ngjarjeje apo veprimi të caktuar dhe informon publikun në lidhje me qëndrimin e grupit të caktuar për një çështje, ndërsa raportimi reaktiv nga mediat bëhet pas ngjarjes, për të rikujtuar atë që ka ndodhur. Kur avokohet për ndonjë ndryshim të politikave rinore, qasja proaktive është e këshillueshme, ndonëse duhet të merren parasysh edhe elementët e mëposhtëm:



Përdorni radiot lokale për të arritur deri tek rinia e zonave rurale

Porosia kryesore - Porosia kryesore është në themel të çdo fushate të informimit mediatic që mëton fitimin e mbështetjes nga publiku. Duhet të përshkruhet qartë gjendja e tanishme (problemi në prapaskenë), dhe zyrtarëve t'u propozohet një zgjidhje për të korrigjuar problemin. KVRL duhet të përfshijë informacione rreth mandatit, misionit, apo kauzës për të cilin po avokon.

Përvijimi i porosisë – Për t'ju shmangur situatave kur mediat përqendrohen jo qëllimshëm në elementin “e gabuar” të një ngjarjeje, KVRL-të mund të mendojnë që ta “përvijojë porosinë e tyre” në vija të trasha, duke i përcaktuar temat kryesore që anëtarët e KVRL do t'i paraqesin para mediave, dhe duke ua shpërndarë ato në formë të shtypur pjesëmarrësve gjatë ngjarjes. Përcaktimi përpara ngjarjes i temave të diskutimit u mundëson përfaqësuesve të mediave që të përqendrohen në porosinë që dëshirohet të përcillet.

Gjetja e çastit të volitshëm për ta përcuar porosinë – Çështjet me rëndësi në nivel lokal mbesin nën hijen e lajmeve nga niveli qendror apo ndërkombëtar. Janë ca hapa që mund të ndërmerren për të siguruar që ngjarjet dhe konferencat të kenë mbulueshmërinë e dëshiruar nga mediat. Një mënyrë është që tema apo çështja të ndërlidhet me lajmet që kanë bërë bujë. Për shembull, nëse keni të bëni me ndonjë aktivitet të dialogut ndëretnik, ai do të kishte më shumë peshë po të ndërlidhej me kontekstin aktual më të gjerë politik. Ndërlidhja e lajmit për ndonjë ndodhi lokale me ndonjë rast të veçantë ose ditë ndërkombëtare të njohur do të mundësojë raportim më të madh në lajme. Për shembull, kur ndonjë KVRL ndërmerr aktivitete të pastrimit të fshatrave nga mbeturinat, ato do të përbëjnë lajm nëse kryhen në Ditën e Tokës. Gjithashtu, duhet të mbani parasysht rregullat vetanake të mediave rreth afateve të raportimit dhe t'i respektoni ato, d.m.th. nëse ata kanë afate të caktuara për ta dërguar materialin qoftë për shtyp apo për redaktim, duhet gjetur çastin më të duhur për ta realizuar ngjarjen ashtu që mediave t'ju mbetet kohë e mjaftueshme për ta përpunuar materialin para dërgimit në shtypshkronjë apo transmetimit. Në fund, sigurohuni që t'ju shmangeni ditëve me lajme të bujshme, siç janë vizitat e nivelit të lartë, ngjarjet politike apo zgjedhjet, e që do ta lënin tërësisht në hije ndonjë ndodhi apo çështje me kontekst më tepër lokal. (Koalicioni për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, "Komunikimi mes OJQ dhe Mediave: Përdorimi i mediave si mjet komunikimi, http://www.amicc.org/docs/NGO-media_training.pdf, 2 shtator 2013).



Përdor internetin. Facebook-un, videot në YouTube, blogjet e shkruara dhe Twitter-in, dhe posto fotografi të ngjarjeve të organizuara në Instagram dhe Flickr për të tërhequr vëmendje.

Si mund t'i përdorin KVRL-të mediat sociale për ngjarjet e tyre?

Aktualisht, mediat sociale janë një nga mjetet më së shumti të përdorura të komunikimit, përmes së cilave mund të krijosh dhe të ndash informacione në mënyrë të shpejtë dhe ekonomike. KVRL-të anembanë Kosovës janë të pranishme në internet dhe përdorin shërbimet në internet për t'ua prezantuar ngjarjet dhe aktivitetet bashkëmoshatarëve të tyre.

Çfarë do t'ju nevojitet për t'u përgatitur për një konferencë të suksesshme për media?

Konferenca për media është mjet efikas i dizajnuar për të gjeneruar lajme dhe publicitet për një organizatë ose ngjarje. Për shembull, në të kaluarën KVRL-të kanë mbajtur konferenca për media pas aprovimit të planeve të tyre të veprimit rinor dhe rregulloreve komunale për vullnetarizëm nga ana e kuvendeve komunale.

Gjërat që duhen mbajtur mend kur përgatitesh për konferencë për media:

- Përkufizo porosinë që dëshiron ta përçosh. Tri deri në pesë argumente të qarta;
- Cakto datën dhe kohën e konferencës për media. Mundohu që t'i shmangesh mbajtjes së konferencës për media në kohë të njëjtë me ngjarje të tjera mediatike;
- Zgjedh një vend të përshtatshëm që ka lidhje me organizatën tuaj, sikurse qendrat rinore;
- Trajno dhe bashkërendo pjesëmarrësit. Mos harro, ata janë fytyra e organizatës tënde;



Përfshij zyrtarin për rini dhe zyrtarin komunal për informim në planifikimin e konferencës për media, për të siguruar mbulueshmëri më të madhe nga mediat.

- Kontakto mediat me kohë dhe bashkërendo me zyrtarin komunal të informimit publik;
- Kontaktoji prapë mediat dhe sigurohu se ato do të marrin pjesë në konferencë;
- Konsidero që të krijosh dosje informative për mediat, me fotografi për mediat e shkruara, komunikatë për media dhe, për shembull, një ekzemplar të publikimit (Manik Begolli, Këshilltar për marrëdhënie me publikun, Deloitte Consulting, Prishtinë).

Çfarë duhet të përfshihet në komunikatën për media?

Kur KVRL komunikon me publikun me anë të një deklaratë për shtyp, mund të konsiderojë që në të t'i përfshijë elementet e mëposhtme:

- Emrin dhe logon e organizatës;
- Informatat e kontaktit të ekspertëve për informacione shitesë;
- Datën;
- Titullin që pasqyron porosinë kryesore;
- Nëntitullin, që shërben për të shtuar një temë të dytë, për të diskutuar planet e ardhshme;
- Një paragraf kryesor që sqaron problemin dhe jep informacionet kryesore;
- Një paragraf të dytë që sqaron sfondin dhe jep kontekstin e problemit;
- Të paktën një citim nga ndonjë ekspert i fushës;
- Zgjidhjen e sugjeruar dhe një thirrje për veprim;
- Një përshkrim të shkurtër të organizatës (një deklaratë të shkurtër të misionit në fund të dokumentit).” Koalicioni për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, “Komunikimi mes OJQ dhe Mediave: Përdorimi i mediave si mjet komunikimi, http://www.amicc.org/docs/NGO-media_training.pdf, 2 shtator 2013.)

Si mund të zhvillohen fushatat e ndërgjegjësimit?

KVRL-të mund të përcjellin porosi dhe të marrin pjesë në aksione nëpërmjet zhvillimit të fushatave. Fushatat janë një varg porosish që kanë të përbashkët një ide apo temë që shfaqet nëpër mjete të ndryshme të informimit për një kohëzgjatje të parashikuar në një moment kohor të caktuar. Kur të marrë vendimin për të organizuar një fushatë, KVRL duhet të ndajë kohë të mjaftueshme për të gjetur një mënyrë tërheqëse ose inovative për paraqitjen e idesë apo temës, që do të përfaqësojë porosinë kryesore që i komunikohet audiencës (Manik Begolli, Këshilltar për marrëdhënie me publikun, Deloitte Consulting, Prishtinë). Viteve të fundit, KVRL-të kanë organizuar dhe kanë marrë pjesë në disa fushata anekënd Kosovës.

ATËHERË, PËRVISHUNI PUNËS!

Mbani në mend, si KVRL, ju gëzoni të drejtë ligjore për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivel komunal, duke marrë pjesë në takime publike, takime me drejtorët për çështje që prekin të rinjtë dhe për të organizuar ngjarje të ndryshme në komunë. Megjithatë, me këto të drejta vjen edhe përgjegjësia për të ushtruar rolin si përfaqësues të të rinjve, duke marrë pjesë aktive në çështjet komunale dhe duke punuar për integrimin e të rinjve. Mos harroni që të kërkonit praktika të mira nga KVRL-të, përveç atyre të identifikuara në këtë dokument, dhe për të krijuar disa tuajat!